



Republika e Kosovës - Republic of Kosova

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Rr. Agim Ramadani p.n. - Qendra e Studentëve 10000 Prishtinë, Tel/Fax: +383(0)38/226-940,
www.sbashk-rks.org E: sbashk2004@yahoo.com, info@sbashk-rks.org

PROKURORISË THEMELORE NË PRISHTINË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

Në bazë të nenit 80 par 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), të cilën e përfaqëson me autorizim zyrtari ligjor Blendor Shatri.

KALLËZIM PENAL

Kundër të dyshuarit: Ministrit të Financave, punës dhe transfereve të Republikës së Kosovës
z. Hekuran Murati.

S E P S E



Për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar – neni 414, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës

I. Përshkrimi i fakteve dhe veprimeve të kundërligjshme

Ekziston dyshimi i bazuar se që nga fundi i vitit 2022, kur ka skaduar mandati i Këshillit Ekonomiko-Social të Republikës së Kosovës, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Murati, nuk ka vepruar në përputhje me kompetencat ligjore për të iniciuar formimin e Këshillit të ri Ekonomiko-Social (KES), siç e parasheh **Ligji Nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social**.

Mosveprimi i tij përbën shkelje të detyrave zyrtare, duke cenuar funksionimin e një organi të pavarur, demokratik dhe ligjor për dialogun social ndërmjet punëdhënësve, të punësuarve dhe qeverisë.

II. Baza ligjore

Neni 3 – Qëllimi i themelimit të Këshillit Ekonomiko-Social

Këshilli Ekonomiko-Social (KES) themelohet me qëllim të vendosjes dhe zhvillimit të dialogut social në Republikën e Kosovës, për të punësuarit dhe punëdhënësit, për çështje të rëndësishë së veçantë që lidhen me realizimin e të drejtave të tyre ekonomike, sociale dhe profesionale.